



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:100093

Datë: 04.04.2023

Numri i dokumentit: 04155280

Pml.nr.102/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarit M.Rr., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.118/2021, të datës 04.10.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.621/2022, të datës 15.12. 2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 27.03. 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e papabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit M. Rr., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.118/2021, të datës 04.10.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.621/2022 të datës 15.12.2022.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.118/2022, të datës 04.10.2022, i dënuari M.Rr. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 28 të KPRK, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK, dhe i është shqiptuar dënimi, për veprën penale të përshkruar si nën I të dispozitivit, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite e 10 (dhjetë) muaj, kurse për

veprën e dytë penale të përshkruar si nën dispozitivin II të aktgjykimit i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 1.500 (njëmijepesëqind) €, të cilin dënim i dënuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në qoftë se i dënuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë në afatin e caktuar ligjor, atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke i llogaritur një ditë burgim me 20 € të gjobës. Në dënimin e shqiptuar të dënuarit i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 02.01.2021 gjerë me datën 13.04.2021, si dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 13.04.2021 gjerë me datën 27.03.2022. Të dënuarit pas shpalljes së aktgjykimit i është caktuar masa e paraburgimit, i cili do të zgjasë gjerë në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar. Të dënuarit i konfiskohen një pistoletë e llojit “ R.” 9x19 mm., me numër serik CH.. dhe .., së bashku me një karikator dhe 7 fishek të kal.9x19 mm. të cilat gjenden në zingjirin e ruajtjes sipas rastit policor ..-.. dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. Është obliguar i dënuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 250 €, paushallin gjyqësor në shumën prej 100 € si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 €.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin e PAKR.nr.621/2022, e datës 15.12.2022, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe përfaqësueses së autorizuar së të dëmtuarve, ankesat e mbrojtësve të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit M.Rr., avokati Fanol Krasniqi nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ndërsa të anulohen aktgjykimet e lartcekura, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallë së parë në rivendosje.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.63/2023, e datës 20.03.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoj pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoj se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë thekson se të dy aktgjykimet janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga 384 paragrafi 1 nën paragrafi.1.12 lidhur me nenin 370 të KPP. Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit të shkallë së parë me shkrim është përcaktuar me dispozitën e nenit 370 të KPP, dhe sipas kësaj dispozite ligjore, gjykata detyrohet që në aktgjykim të përfshijë të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 365 të këtij kodi, kjo nuk është bërë, ngase në momentin kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave ligjore

nga neni 248 të KPP, meqë gjykata është dashur të vlerësoj se i akuzuari a e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, kurse në rastin konkret rezulton se nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të dënuarit, vlerëson se aktgjykimet e kundërshtuara si tërësi, pra edhe dispozitivët e të njëjtëve janë të qartë, të kuptueshëm dhe nuk përmbajnë kundërthënie me vetveten ose me arsyet e paraqitura. Aktgjykimi i shkallës së parë është përpiluar dhe i përmban të gjitha të dhënat të cilat duhet ti përmbaj aktgjykimi me shkrim në pajtim me nenin 369 lidhur me nenin 364 të KPP, prandaj pretendimet e mbrojtësit në kërkesë në këtë drejtim janë të pabazuara.

Po ashtu fillimisht është e nevojshme të theksohet fakti se i dënuari në shqyrtimin gjyqësor e ka bërë pranimin e fajësisë dhe atë në prezencën dhe në konsultim me mbrojtësen e tij. I dënuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk i kundërshton provat në të cilat mbështetet aktakuza dhe e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat ngarkohet. Si rezultat i konstatimit të tillë, gjykata ka vlerësuar se janë përmbushur kriteret e përcaktuara dhe se pranimi i fajësisë mbështetet me faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime teknike, pranimi i fajësisë ishte aprovuar, andaj, pretendimet e mbrojtësit të dënuarit lidhur me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale janë të pabazuara.

Po ashtu pretendimi i mbrojtjes se i dënuari ka pasur dilema rreth pranimi të fajësisë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron për faktin se nga shkresat e lëndës-procesverbali i datës 15.09.2022, rezulton se pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarit është bërë konform dispozitës së nenit 241 të KPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimet e mbrojtësit të dënuarit për shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit janë të paqëndrueshme, sepse me aktgjykimet e kundërshtuara nuk është shkelur ligji penal siç pretendohet nga mbrojtësi për faktin se në gjendjen faktike të provuar, në veprimet e të dënuarit formohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.102/2023, më 27.03.2023

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi